



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P.770/2017

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Leonard Gremshi	Zv/Kryetar
Hektor Balluku	Anëtar
Kleves Janku	Anëtar
Odise Moçka	Anëtar

Në mbledhjen e datës 11.12.2017 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Modifikimi i dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr.REF-28817-10-06-2017, me objekt : “Sistemi Wi-Fi per qytetin, shkollat dhe qendra te populluara te njesive administrative”, me fond limit 12 279 042 lekë pa tvsh, parashikuar për tu zhvilluar më datë 30.10.2017 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Malësi e Madhe.

Ankimues: “B360” shpk
Adresa: Rruga: “Papa Gjon Pali II”, Pallati 11/1 Ap.11
Tiranë

Autoriteti Kontraktor Bashkia Malësi e Madhe
Koplik, Malësi e Madhe

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.914 datë 29.12.2014 “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “Për Miratimin e Rregullores “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar;

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 06.10.2017 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr.REF-28817-10-06-2017, me objekt : “Sistemi Wi-Fi per qytetin, shkollat dhe qendra te populluara te njesive administrative”, me fond limit 12 279 042 lekë pa tvsh, parashikuar për tu zhvilluar më datë 30.10.2017 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Malësi e Madhe.

II.2. Në datën 12.10.2017 operatori ekonomik “B360” shpk, ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kërkuar modifikimin e dokumentave të procedurës së mësipërme të prokurimit me argumentat si më poshtë:

[...]

Ankesë 1

Në dokumentin e projektit teknik të dhënë nga ana juaj nuk paraqitet topologjia e rrjetit mbi projektin që kërkohet të zbatohet. Në mënyrë që të gjykohet mbi zgjidhje sa më të mirë konform kërkesave teknike kërkohet një hartë reale nga projektuesit me të gjitha pozicionet ku të vendosen cdo zë i preventivit të dhënë nga ana juaj. Mungesa e Projektit sjell paqartësi mbi zbatimin e tij dhe mënyrën e implementimit të tij:

Në lidhje me Acces Point që do të lidhen në switch 16 porta të këkuara nga ana juaj të cilës sipas llogaritjeve i bie të jenë 58 copë do të na duhen harta e vendosjes së secilit prej këtyre sëitch për të parë sesa acces point do të vendosen në një sëitch 16 porta. Në dokumentin e specifikimeve teknike paraqitet që duhet të instalohen 7 kabinete outdoor. Duke qënë se lidhja e këtyre kabineteve me sëitch 24 porta do të bëhet me anë të fibrës optike do të na duhet pozicioni i secilit prej tyre sepse

në rast se do të ishte një distancë e vpgël nga sëitch përse duhet të përdoret fiber optike e tipit single mode duke qënë se ky funksion mund të kryhet me të njëjtën cilësi dhe me fiber optike Multi mode.

Kërkojmë të jëpet harta me vendosjen reale të cdo produkti hardëare të kërkuar nga ana juaj në preventivin e dhënë Acces Point, Sëitch 8;16;24; porta, kabinet etj.

Tipi i fibrës të jetë single mode/multi mode duke qënë se funksionalitetit i tyre do të ishte i njëjtë.

Ankesë 2

Sipas specifikimeve teknike të sëitcheve ju keni kërkuar disa karakteristika që të cojnë në advanced Layer 3 switches, dhe që nuk justifikohet për funksionimin që ato janë kërkuar. Ju lutem arsyetoni përse nevojiten karakteristikat e renditura më poshtë, si është menduar konfigurimi ose ju kërkojmë heqjen e tyre.

Policy-based routing (PBR)	Po
Routimi	Statik/ Dinamik, BGP, OSPF, IS-IS, ARP, IGMPv1/v2/v3
Access Control List	L2 - L4

Kërkojmë duke qënë se këto kërkesa në lidhje me sëitch janë të ekzagjëruara për funksionin që ato do të kryejnë kërkojmë heqjen e karakteristikave të mësipërme.

Ankesë 3

Projekti i paraqitur nga ana juaj është i paraqitë dhe për këtë arsye ju lutem jepni përgjigje pyetjeve si më poshtë:

Në dst të tenderit kërkohen 76 akses pointe, ndërsa në specifikimet e kontrollerit kërkohet që ai të suportoje minimalisht 50AP (në varësi të zgjidhjes). Nëse kontrolleri suporton vetëm 50AP si është menduar lidhja e 26 Aps shtesë?

Në faqen 14 të specifikimeve teknike shprehet fjalia si më poshtë:

- Sistemi do të jetë i konfigurueshëm të drejtojë klientët në një faqe të dedikuar që do të jete sistemi nderveprues is shprehur ne piken 7 me lart.

Ju lutem kërkojmë tepër detaje, ku konsiston konfigurimi që shprehet mësipër (sistemi do të jetë i konfigurueshëm)?

Nëse kërkohet që sistemi të jetë i konfigurueshëm , kush do ta bëjë konfigurimin? Nëse konfigurimi duhet të bëhet nga punonjësit e bashkisë cfarë kërkohet të konfigurohet specifikisht? Lidhur me informacionin që kërkohet të merret nga përdoruesi në momentin e lidhjes në internet, ju nuk keni specifikuar sesi keni menduar ta realizoni këtë funksionalitet. Cfarë fushash do të kërkohen nga përdoruesi edhe cfarë raportesh do të gjenerohen nga sistemi? Cfarë teknologjie do të përdoret për realizimin e këtij sistemi? Cfarë infrastrukture aktuale ka bashkia? A ka ndonjë external server

edhe me cfarë parametrash që mund të shfrytëzohet për këtë qëllim? Referuar specifikimeve teknike të Media converter sic praqitet në faqen 17, kërkohet që Netëork Media të jetë UTP category 5, ndërkohë që kablli i bakrit kërkohet që të jetë cat 6. Ju lutem specifikoni më qartësisht tipin e kabllit të bakrit që duhet të përdoret?

Nuk është e qartë nëse në zyrën e bashkisë ku mendohet të instalohet sëitch me 24 porta ka një kabinet ekzistues apo jo. Kërkohet që të dihet se ku do të bëhet instalimi i këtij sëitch-i si dhe në rast se do të jetë nevoja për kabinet, sygjerohet që të shtohet në preventivin e këtij projekti.

Ku do të instalohet fireëall? Aduhet të jetë rack mounted apo jo?

Ëshjtë kërkuar që të instalohen 7 kabinete outdoor por nuk ka kërkesa specifike mbi karakteristikat minimale për to. Sa HU kërkohet që të jenë në kabinetet? S a do të jenë dimesionet e tyre (thellësi gjerësi etj). A ka preferencë për ngjyrën (gri/e zezë etj)?

Cfarë është menduar që të lidhet në UPS që do të instalohet në Bashkinë Koplik?

Aka monitor të instaluar në rrjetin e brendshëm të bashkisë? Për të aksesuar ndërfaqen e ëireless controller si dhe në ndërfaqen e raportimeve sic kërkohen në specifikimet teknike.

Në lidhje me sëitch 8 porta ju lutem përcaktoni ku do të instalohen 4 sëitch të kërkuar nga ana juaj? Ju përcaktoni që një do të jetë në Bajzë dhe një në Gruemiere. Ku do të instalohen 2 sëitch e mbetur? Gjithashtu ju lutem përcaktoni a ka rack ekzistues në secilin prej vendeve ku do të instalohen sëitch.

Shtrimi i fibrës optike nuk paraqitet në preventiv nëse është pjesë e këtij projekti? Apo do të bëhet nga palë tjetër? Nëse do të bëhet nga i njëjti kontraktues do të merret parasysh në ofertën e cmimit në të njëjtin zë që është edhe fibra? Nëse do të kryhet nga ana jonë shtrirja e fibrës do të bëhet në tubacionet ekzistues apo do të shtrihen tubacione të reja?

Ankesë 4

Në lidhje me Fireëall për të gjithë sistemin e kërkuar nga ana juaj nuk gjykohet aspak e nevojshme që sistemi i parandalimit të ndërhyrjeve (IPS) të procesojë në vlerat e dhëna më e madhe =7 Gbps bazuar në trafiku UDP dhe më e madhe =5 Gbps bazuar në trafik tcp vlere e mjaftueshme do të jetë minimalisht më e madhe = 2.5 Gbps.

Gjithashtu në lidhje me licencën e firëall-it duhet të merret e mirëqënë që edhe ajo do të pajiset me licencë 4 vjecare ashtu si dhe url filtering apo është parashikuar një kohëzgjatje tjetër e papërcaktuar në dokument Ju lutem saktësojeni.

II.3. Në datën 18.10.2017, me shkresën nr. 4232 prot, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues “B360” sh.p.k. është vënë në dijeni në lidhje me refuzimin e ankesës.

II.4. Në datën 25.10.2017 pala ankimuese “B360” sh.p.k, ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me argumentimin si më poshtë vijon:

[....]

Në ankesën nr 1 të datës 11.10.2017 të paraqitur nga ana jonë kemi kërkuar:

Në dokumentin e projektit teknik të dhënë nga ana juaj nuk paraqitet topologjia e rrjetit mbi projektin që kërkohet të zbatohet. Në mënyrë që të gjykohet mbi zgjidhje sa më të mirë konform kërkesave teknike kërkohet një hartë reale nga projektuesit me të gjitha pozicionet ku të vendosen cdo zë i preventivit të dhënë nga ana juaj. Mungesa e Projektit sjell paqartësi mbi zbatimin e tij dhe mënyrën e implementimit të tij:

Në lidhje me Acces Point që do të lidhen në sëitch 16 porta të këkuara nga ana juaj të cilës sipas llogaritjeve i bie të jenë 58 copë do të na duhen harta e vendosjes së secilit prej këtyre sëitch për të parë sesa acces point do të vendosen në një sëitch 16 porta. Në dokumentin e specifikimeve teknike paraqitet që duhet të instalohen 7 kabinete outdoor. Duke qënë se lidhja e këtyre kabineteve me sëitch 24 porta do të bëhet me anë të fibrës optike do të na duhet pozicioni i secilit prej tyre sepse në rast se do të ishte një distancë e vpgël nga sëitch përse duhet të përdoret fiber optike e tipit single mode duke qënë se ky funksion mund të kryhet me të njëjtën cilësi dhe me fiber optike Multi mode.

Kërkojmë të jëpet harta me vendosjen reale të cdo produkti hardëare të kërkuar nga ana juaj në preventivin e dhënë Acces Point, Sëitch 8;16;24; porta, kabinet etj.

Tipi i fibrës të jetë single mode/multi mode duke qënë se funksionalitetit i tyre do të ishte i njëjtë.

Në përgjigjen e datës 18.10.2017 Bashkia Malësi e Madhe është përgjigjur:

Projekti duhet kuptuar si një i tërë dhe me “celësa në dorë”. Kështu që cdo produkt apo pjesë përbërëse e projektit do të kualifikohet nga autoriteti kontraktor nëse realizon projektin dhe qëllimin e tij. Harta e mbulimit dhe vendosja e akses pointeve për zonat dhe hapsirat e mbulimit të specifikuara në projekt duhet të bëhet nga operatori ekonomik.

Fibra optike mund të jetë single ose Multimode kuptohet në varësi të distancës që del nga harta e mbulimit.

Arsyetimi KPP

Referojmë LPP-në dhe RrPP neni 32 [...]

Procedura e prokurimit e publikuar nga AK-ja është një procedurë e hapur Shërbime dhe jo Konkurs Projektimi. Pavarsisht faktit që projekti është kërkuar me celësa në dorë kjo nuk do të thotë që projektimi i mënyrës sesi do të bëhet shtrimi instalimi dhe implementimi i të gjithë sistemeve të bëhet nga ana e oe-ve. Gjithashtu nëse do të merrnim në konsideratë dhe afatin brenda së cilit duhet të realizohen kontrata sjellin në vëmendjen tuaj që vec projektimi i mënyrës së vendosjes dhe instalimit të pajisjeve do të donte një kohë të konsiderueshme. Nuk është aspak detyrë e oe-së plotësimi i kriterit:

“Hartave të mbulimit dhe vendosja e akses pointeve për zonat dhe hapsirat e mbulimit të specifikuara në projekt duhet të bëhet nga operatori ekonomik”.

Minimalisht nga ana e ak-së duhet të paraqiten të sakta kërkesat mbi të cilat do të realizohet ky projekt . Nuk mund të pretendohet që mjafton të jëpet vetëm qëllimi i projektit për ta realizuar atë. Për secilën nga zonat e kërkuara në DST.

- Bulevardi kryesor te Bashkise Malesi e Madhe

- Shkolla Sherif Hoxha

- Sheshi, rruga kryesore dhe shkolla Prek Gjoni te qendres se Bajzes

- Sheshi dhe shkolla Gruemire e qendres se Njesise Administrative Gruemire duhet minimalisht të përcaktohet vendosja e Akses Point dhe kabineteve që do të shërbejnë edhe për llogaritjen e distancave dhe përpilimin e ofertës. Nga ana tjetër ju keni kërkuar një sasi të përcaktuar të kabujve përkatësisht 1800m Fiber optike dhe 6180 Kbaëll ftp cat 6, që do të thotë që ju keni një project që keni llogaritur distance. Ju lutem na vini në diospozicion këtë project në mënyrë që oferta jonë të jetë conform zgjidhjes që ju keni paramenduar. Përgjigjia juaj se harta e mbulimit dhe vendosja e akses pointeve për zonat dhe hapsirat e mbulimit të specifikuara në project duhet të bëhet nga oe-ja nuk justifikon mungesën e projektit fillesatr nga i cili është nisur bashkia për përcaktimin e këtyre sasive të nevojshme për realizimin e qëllimit të këtij projekti.

AK-ja është shprehur që fibra optike mund të jetë single mode ose multimode në varësi të distancës. Sjellim në vëmendjen tuaj faktin që vlera monetare e të dy llojeve të fibrës është konsiderueshëm e ndryshme dhe për këtë arsye sasia e tyre do të ndikonte shumë në koston e të gjithë projektit. Distanca e kabineteve nga sëitch në këtë rast do të ishte tepër e nevojshme për të përcaktuar tipin dhe sasinë e fibrës optike që do të përdoret. Kërkesa e AK-së që oe-ja do të jetë ai që do të bëjë hartat e mbulimit dhe vendosjes së akses pointeve për zonat dhe hapsirat e mbulimit të specifikuara është totalisht absurd dhe e pabazuar në ligj.

Kërkesë 1 KPP

Kërkojmë dhënien e hartave të mbulimit dhe vendosjes së akses point të gjithë komponentëve të tjerë të kërkuar në preventivin e dhënë si kabinete sëitch media converter etj.

Ankesë 2

Në ankesën nr.2 të datës 11.10.2017 të paraqitur nga ana jonë kemi kërkuar :

Ankesë 2

Sipas specifikimeve teknike të sëitcheve ju keni kërkuar disa karakteristika që të cojnë në advanced Layer 3 sëitchet, dhe që nuk justifikohet për funksionimin që ato janë kërkuar. Ju lutem arsyetoni përse nevojiten karakteristikat e renditura më poshtë, si është menduar konfigurimi ose ju kërkojmë heqjen e tyre.

Policy-based routing (PBR)	Po
Routimi	Statik/ Dinamik, BGP, OSPF, IS-IS, ARP, IGMPv1/v2/v3
Access Control List	L2 - L4

Kërkojmë duke qënë se këto kërkesa në lidhje me sëitch janë të ekzagjëruara për funksionin që ato do të kryejnë kërkojmë heqjen e karakteristikave të mësipërme.

Në përgjigjen e datës 18.11.2017 Bashkia Malësi e Madhe është përgjigjur:

Sëitchet mund të lexohen si Lyer 2 sëitchet port e menaxhueshëm. Kështu që funksionet të cilat ju ankimoni duhen parë vetëm në një "Layer 2 sëitchet" dhe të menaxhueshëm.

Arsyetimi për KPP

Përgjigjia e dhënë nga ana e Bashkisë Malësi e madhe është totalisht e paqartë dhe e pakuptimtë pasi nuk shprehet nëse është pranuar që sëith të jetë "Layer 2" dhe janë hequr karakteristikat që të

cojnë në “Layer 3” dhe rëndësi ka vetëm që të jetë i menaxhueshëm apo nuk është pranuar. Duke qënë se kërkesat për sëitch janë të ekzagjëruara për funksionin që kërkohet të kenë dhe frynë pa arsye kostot e projektit kërkojmë që karakteristikat Policy-based routing (PBR), Routimi Statistik/Dinamik, BGP, OSPF, IS-IS, ARP, IGMPv1/v2/v3, Access Control List L2- L4 të hihen ose të vihen opsionale.

Kërkesë 2 KPP

Të hiqen ose të bëhet opsionale kërkesat e sëitch si mëposhtë:

Policy-based routing (PBR)	Po
Routimi	Statik/ Dinamik, BGP, OSPF, IS-IS, ARP, IGMPv1/v2/v3
Access Control List	L2 - L4

Ankesë 3

Në ankesën nr. 3 pika 3 të datës 11.10.2017 të paraqitur nga ana jonë kemi kërkuar:

Referuar specifikimeve teknike të Media converter sic praqitet në faqen 17, kërkohet që Netëork Media të jetë UTP category 5, ndërkohë që kablli i bakrit kërkohet që të jetë cat 6. Ju lutem specifikoni më qartësisht tipin e kabllit të bakrit që duhet të përdoret?

Në përgjigjen e datës 18.10.2017 Bashkia Malësi e Madhe është përgjigjur:

Pika 3 Është e qartë nga specifikimet dhe projekti që media konverteri deri tek sëitchi mund të jetë cat5 ndërsa kabulli që lidh akses pointet me sëitchet duhet të jetë cat 6.

Arsyetimi për KPP

Sipas përgjigjes së dhënë nga AK-ja është përcaktuar që lidhja nga media converter deri tek sëitchet do të bëhet me cat 5 FTP ose UTP, por nuk është përcaktuar në asnjë zë të preventivit të dhënë sasia e tij. Në këto kushte duke qënë se sasia e kabllit është e rëndësishme për vlerësimin e cmimit të ofertës së operatorit ekonomik kërkojmë.

Kërkesë 3KPP

Vendosjen në preventivin e mallrave të zërit “Kabëll Kategoria 5” me sasinë përkatëse.

Ankesë 4 Në ankesën nr. 3 pika 10 të datës 11.10.2017 të paraqitur nga ana jonë kemi kërkuar:

Shtrimi i fibrës optike nuk paraqitet në preventiv nëse është pjesë e këtij projekti? Apo do të bëhet nga palë tjetër? Nëse do të bëhet nga i njëjtii kontraktues do të merret parasysh në ofertën e cmimit në të njëjtin zë që është edhe fibra? Nëse do të kryhet nga ana jonë shtrirja e fibrës do të bëhet në tubacionet ekzistues apo do të shtrihen tubacione të reja?

Në përgjigjen e datës 18.10.2017 Bashkia Malësi e Madhe është përgjigjur:

Pika 10 Projekti do të konsiderohet si me “celësa në dorë”. Të gjitha punimet e nevojshme për fibrën optike, shtrim kabulli bakri, montim aksles pointesh, montim rackesh duhet të ofrohen dhe do të kryhen nga oe fitues. Po duhet marrë parasysh në të njëjtin cmim është edhe fibra. Në varësi të

hartës së mbulimit duhet të merret parasysh dhe shtrimi i fibrës. Në rastet kur ekziston tubacioni ekzistues do përdoret ai në rastet kur nuk ekziston do të shtrihet i ri.

Arsyetimi KPP

Koncepti me “celësa në dorë” nuk mund të nënkuptojë që zërat si hapje kanalizimesh dhe shtrim tubacionesh përfshihen në zërin fibra. Hapja e kanalizimeve dhe shtrirja e tubacioneve të reja është një pikë kryesore për krijimin e rrjetit të kërkuar, por që ngelet tërësisht e patrajtuar në dst Në varësi të hartës së mbulimit autoriteti është i detyruar të japë minimalisht kanalizimet ekzistuese që mund të përdoren në mënyrë që operatori të mund të gjykojë mbi sasinë e zërit shtrirje dhe instalim fibre, ku do të përfshijë (hapje kanalizimes të reja shtrirje tubacionesh)etj. Fakti që shtrirja e fibrës optike do të bëhet nga oe-ja duhet të ishte theksuar që në projektin e dhënë nga ana juaj pasi sasia e punimeve civile tubacioneve të reja që do të shtrihen etj janë zëra të cilat kanë një ndikim të tepërt të konsiderueshëm në koston e të gjithë projektit. Minimalisht K-ja duhet të kishtë përcaktuar qrtë rrugën në të cilën do të shtrihet fibra optike pjesët që do të shtrihen në kanalizimet ekzistuese dhe ato pjesë për të cilat do të ishte e nevojshme shtrirja e tubacioneve të reja dhe kanalizimeve të reja. Gjithashtu nuk është përcaktuar se në pronësi të kujt do të jenë makineritë me anë të të cilave do të kryhen punimet civile si psh carja e asfaltit gërmimi etj. Sipas një llogjike të thjeshtë presupozohet që do të jenë në pronësi të Bashkisë përderisa nuk është kërkuar asnjë makineri nga ana e oe-së apo gjatë realizimit të projektit mund të pretendohet që oe –ja duhet ta dinte që duhet të kishte në pronësi këto lloj makinerish,.

Kërkesë 4 KPP

Të përcaktohen kanalizime ekzistuese ku do të kalojë fibra optike dhe kanalizimet e reja. Shumë të nderuar anëtarë të KPP

Nga ana e AK-së është përcaktuar që o të jetë OE-ja ai i cili do të përcaktojë hartat me vendosjet e të gjithë pajisjeve të kërkuara ndërkohë që nuk ka të dhënë qoftë edhe një planimetri të zonës. Minimalisht do të duhej që të ishte kërkuar një vizitë on site dhe jo më të dilte pas ankimit tonë fakti që fibra do të instalohet nga oe-ja (ju kujtojmë që nuk është bërëpublike asnjë shtojcë për operatorët e tjerë ekonomik në lidhje me shtrirjen e fibrës optike) për të parë terrenin ku do të bëhej shtrirja e fibrës optike e më pas të vlerësohej nga ana e operatorit ekonomik sasia e përafërt e kablove fibrës tubacioneve dhe elementëve të tjerë të cilët janë tepër të rëndësishëm në ofertim. Është shumë e vështirë për një operator ekonomik të marrë pjesë në një procedurë prokurimi kur nuk e ka idenë më të vogël në lidhje me mënyrën e instalimit dhe vendosjes së pajisjeve.

- Kërkojmë dhënien e hartave të mbulimit dhe vendosjejes së akses point të gjithë komponentëve të tjerë të kërkuar në preventivin e dhënë si kabinete sëitch media converter etj
- Të hiqet ose të bëhet opsionale kërkesat e sëitch si mëposhtë:

Policy-based routing (PBR)	Po
Routimi	Statik/ Dinamik, BGP, OSPF, IS-IS, ARP, IGMPv1/v2/v3
Access Control List	L2 - L4

- Të bëhet vendosja në preventivin e mallrave të zërit “Kabëll Kategoria 5” me sasinë përkatëse
- Të përcaktohet kanalizime ekzistues dhe ku do të kalojë fibra optike dhe kanalizimet e reja.

II.5. Nëpërmjet shkresës nr. 4492 prot, datë 03.11.2017 protokolluar me tonën me shkresën nr. 1679/2, datë 06.11.2017 me objekt “Dërgohet informacion”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.6. Në datën 30.10.2017 autoriteti kontraktor Bashkia Malësi e Madhe ka vijuar me hapat e mëtejshëm të procedurës duke kryer “Hapjen e Ofertave”.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e palës ankimuese mbi modifikimin e dokumentave të tenderit me argumentin se “Referojmë LPP-në dhe RrPP neni 32 [...]Procedura e prokurimit e publikuar nga AK-ja është një procedurë e hapur Shërbime dhe jo Konkurs Projektimi. Pavarsisht faktit që projekti është kërkuar me ccelësa në dorë kjo nuk do të thotë që projektimi i mënyrës sesi do të bëhet shtrimi instalimi dhe implementimi i të gjithë sistemeve të bëhet nga ana e oe-ve. Gjithashtu nëse do të merrnim në konsideratë dhe afatin brenda së cilit duhet të realizohen kontrata sjellin në vëmendjen tuaj që vec projektimi i mënyrës së vendosjes dhe instalimit të pajisjeve do të donte një kohë të konsiderueshme. Nuk është aspak detyrë e oe-së plotësimi i kriterit:

“Hartave të mbulimit dhe vendosja e akses pointeve për zonat dhe hapsirat e mbulimit të specifikuara në projekt duhet të bëhet nga operatori ekonomik”.

Minimalisht nga ana e ak-së duhet të paraqiten të sakta kërkesat mbi të cilat do të realizohet ky projekt . Nuk mund të pretendohet që mjafton të jepet vetëm qëllimi i projektit për ta realizuar atë. Për secilën nga zonat e kërkuara në DST.

- Bulevardi kryesor te Bashkise Malesi e Madhe

- Shkolla Sherif Hoxha

- Sheshi, rruga kryesore dhe shkolla Prek Gjoni te qendres se Bajzes

- Sheshi dhe shkolla Gruemire e qendres se Njesise Administrative Gruemire duhet minimalisht të përcaktohet vendosja e Akses Point dhe kabineteve që do të shërbejnë edhe për llogaritjen e distancave dhe përpilimin e ofertës. Nga ana tjetër ju keni kërkuar një sasi të përcaktuar të kabujve përkatësisht 1800m Fiber optike dhe 6180 Kabëll ftp cat 6, që do të thotë që ju keni një projekt që keni llogaritur distance. Ju lutem na vini në diospozicion këtë projekt në mënyrë që oferta jonë të jetë konform zgjidhjes që ju keni paramenduar.Përgjigjia juaj se harta e mbulimit dhe vendosja e akses pointeve për zonat dhe hapsirat e mbulimit të specifikuara në project duhet të bëhet nga oe-ja

nuk justifikon mungesën e projektit fillesat nga i cili është nisur bashkia për përcaktimin e këtyre sasive të nevojshme për realizimin e qëllimit të këtij projekti.

AK-ja është shprehur që fibra optike mund të jetë single mode ose multimode në varësi të distancës. Sjellim në vëmendjen tuaj faktin që vlera monetare e të dy llojeve të fibrës është konsiderueshëm e ndryshme dhe për këtë arsye sasia e tyre do të ndikonte shumë në koston e të gjithë projektit. Distanca e kabineteve nga sëitch në këtë rast do të ishte tepër e nevojshme për të përcaktuar tipin dhe sasinë e fibrës optike që do të përdoret. Kërkesa e AK-së që oe-ja do të jetë ai që do të bëjë hartat e mbulimit dhe vendosjes së akses pointeve për zonat dhe hapsirat e mbulimit të specifikuara është totalisht absurd dhe e pabazuar në ligj.

Kërkesë 1 KPP

Kërkojmë dhënien e hartave të mbulimit dhe vendosjes së akses point të gjithë komponentëve të tjerë të kërkuar në preventivin e dhënë si kabinete sëitch media converter etj.”Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në dokumentat e tenderit “*Termat e Referencës*” pika 10. “*Planifikimi i Buxhetit për Ndërtimin e Sistemit*” është kërkuar:

PLANIFIKIMI I BUXHETIT PËR NDËRTIMIN E SISTEMIT

Me poshte paraqitet tabela e planifikimit te buxhetit:

Nr.	Emertimi	Sasia	Cmimi	Vlera
1	Implementimi, konfigurimi i sistemit ëfi	1		
2	UPS ne qendrën e bashkisë dhe njesi	1		
3	Ëireless kontroller	1		
4	Licenca per menaxhim akses point	76		
5	Sëitch 24 porta	1		
6	Sëitch 16 porta	7		
7	Sëitch 8 porta	4		
8	Media konverter	14		
9	Fireëall	1		
10	OutDoor Access Point	76		
11	Fiber optike	1800		

12	Kostot kablli ftp cat 6	6180		
13	Outdoor Cabinets	7		
14	Dizenjimi, implementim dhe dokumentimi i sistemit nderveprues dhe raportimit	1		
15	Trajnimi i stafit IT te Bashkise	1		
	Totali (Leke me tvsh)			

III.1.2. Në nenin 28, pika 2 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se: 2. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

III.1.3. Operatori ekonomik ankimes pretendon se: [..]Procedura e prokurimit e publikuar nga AK-ja është një procedurë e hapur Shërbime dhe jo Konkurs Projektimi. Pavarsisht faktit që projekti është kërkuar me ccelësa në dorë kjo nuk do të thotë që projektimi i mënyrës sesi do të bëhet shtrimi instalimi dhe implementimi i të gjithë sistemeve të bëhet nga ana e oe-ve. Gjithashtu nëse do të merrnim në konsideratë dhe afatin brenda së cilit duhet të realizohen kontrata sjellin në vëmendjen tuaj që vec projektimi i mënyrës së vendosjes dhe instalimit të pajisjeve do të donte një kohë të konsiderueshme. Nuk është aspak detyrë e oe-së plotësimi i kriterit:

“Hartave të mbulimit dhe vendosja e akses pointeve për zonat dhe hapsirat e mbulimit të specifikuar në projekt duhet të bëhet nga operatori ekonomik”.

Minimalisht nga ana e ak-së duhet të paraqiten të sakta kërkesat mbi të cilat do të realizohet ky projekt . Nuk mund të pretendohet që mjafton të jepet vetëm qëllimi i projektit për ta realizuar atë. Për secilën nga zonat e kërkuara në DST.

- Bulevardi kryesor te Bashkise Malesi e Madhe

- Shkolla Sherif Hoxha

- Sheshi, rruga kryesore dhe shkolla Prek Gjoni te qendres se Bajzes

- Sheshi dhe shkolla Gruemire e qendres se Njesise Administrative Gruemire duhet minimalisht të përcaktohet vendosja e Akses Point dhe kabineteve që do të shërbejnë edhe për llogaritjen e distancave dhe përpilimin e ofertës. Nga ana tjetër ju keni kërkuar një sasi të përcaktuar të kabujve përkatësisht 1800m Fiber optike dhe 6180 Kabëll ftp cat 6, që do të thotë që ju keni një projekt që keni llogaritur distance. Ju lutem na vini në diospozicion këtë projekt në mënyrë që oferta jonë të jetë konform zgjidhjes që ju keni paramenduar.Përgjigjia juaj se harta e mbulimit dhe vendosja e akses pointeve për zonat dhe hapsirat e mbulimit të specifikuar në project duhet të bëhet nga oe-ja

nuk justifikon mungesën e projektit fillesat nga i cili është nisur bashkia për përcaktimin e këtyre sasive të nevojshme për realizimin e qëllimit të këtij projekti.[...]

III.1.4. Autoriteti kontraktor argumenton se: [...] Projekti duhet kuptuar si një i tërë dhe me “celësa në dorë”. Kështu që cdo produkt apo pjesë përbërëse e projektit do të kualifikohet nga autoriteti kontraktor nëse realizon projektin dhe qëllimin e tij. Harta e mbulimit dhe vendosja e akses pointeve për zonat dhe hapsirat e mbulimit të specifikuara në projekt duhet të bëhet nga operatori ekonomik.

Fibra optike mund të jetë single ose Multimode kuptohet në varësi të distancës që del nga harta e mbulimit.[...]

III.1.5. Në ligjin nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 23 pika 1, 2 dhe 3, parashikohet se :

“1. Specifikimet teknike, që përcaktojnë karakteristikat e mallrave, punëve dhe shërbimeve që do të prokurohen, duhet të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit kontraktor, duke iu referuar:

a) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve apo përdorimin e produkteve;

b) kërkesave në terma funksionalë, kur një gjë e tillë kërkon t’u referohesh standardeve kombëtare ose ndërkombëtare, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

c) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni për mallra, shërbime apo punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

III.1.6. Sa më sipër analizuar, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton se autoriteti kontraktor në pikën 10 të projektit konkretisht: “Planifikimi i Buxhetit për ndërtimin e sistemit” (pika 8 Media Converter) ka parashikuar një sasi të caktuar të media converter. Në këtë kuptim Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, autoriteti kontraktor ka një planifikim të caktuar në lidhje me sasinë e pikave që do të lidhen me kabëll ethernet dhe atyre që do të lidhen me fiber.

Në rastin konkret, autoriteti kontraktor duhet të parashikojë projektin fillestar nga i cili është nisur ky i fundit për përcaktimin e këtyre sasive të nevojshme për realizimin e qëllimit të këtij projekti. Në këtë kuptim Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se autoriteti kontraktor dhe konkretisht Bashkia Malësi e Madhe duhet të japë ose të paraqesë në projektin e hartuar nga vetë ata hartën e zonave ku ky shërbim do të ofrohet.

Për rrjedhojë pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e palës ankimuese mbi modifikimin e dokumentave të tenderit me argumentin se “Në ankesën nr.2 të datës 11.10.2017 të paraqitur nga ana jonë kemi kërkuar :

Ankesë 2

Sipas specifikimeve teknike të switcheve ju keni kërkuar disa karakteristika që të cojnë në advanced Layer 3 switches, dhe që nuk justifikohet për funksionimin që ato janë kërkuar. Ju lutem arsyetoni përse nevojiten karakteristikat e renditura më poshtë, si është menduar konfigurimi ose ju kërkojmë heqjen e tyre.

Policy-based routing (PBR)	Po
Routimi	Statik/ Dinamik, BGP, OSPF, IS-IS, ARP, IGMPv1/v2/v3
Access Control List	L2 - L4

Kërkojmë duke qënë se këto kërkesa në lidhje me switch janë të ekzagjëruara për funksionin që ato do të kryejnë kërkojmë heqjen e karakteristikave të mësipërme.

Në përgjigjen e datës 18.11.2017 Bashkia Malësi e Madhe është përgjigjur:

Switchet mund të lexohen si Layer 2 sëtiches port e menaxhueshëm. Kështu që funksionet të cilat ju ankimoni duhen parë vetëm në një “Layer 2 sëtiches” dhe të menaxhueshëm.

Arsyetime për KPP

Përgjigjja e dhënë nga ana e Bashkisë Malësi e madhe është totalisht e paqartë dhe e pakuptimtë pasi nuk shprehet nëse është pranuar që sëith të jetë “Layer 2” dhe janë hequr karakteristikat që të cojnë në “Layer 3” dhe rëndësi ka vetëm që të jetë i menaxhueshëm apo nuk është pranuar. Duke qënë se kërkesat për sëtich janë të ekzagjëruara për funksionin që kërkohet të kenë dhe frynë pa arsye kostot e projektit kërkojmë që karakteristikat Policy-based routing (PBR), Routimi Statik/Dinamik, BGP, OSPF, IS-IS, ARP, IGMPv1/v2/v3, Access Control List L2- L4 të hihen ose të vihen opsionale.

Kërkesë 2 KPP

Të hiqen ose të bëhet opsionale kërkesat e sëtich si mëposhtë:

Policy-based routing (PBR)	Po
Routimi	Statik/ Dinamik, BGP, OSPF, IS-IS, ARP,

	IGMPv1/v2/v3
Access Control List	L2 - L4

“, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se

III.2.1. Në dokumentat e tenderit “*Specifikime teknike*” pika 14. “*Karakteristikat minimale teknike Sëich 24,16 dhe 8 porta L3*” është kërkuar:

Switch

Karakteristika Minimale Teknike Switch 24, 16 dhe 8 porta L3	
Sëitch 24,16,8 Port L3	
Porta PoE 10/100/1000Mbps RJ45 (Auto Negocim /Auto MDI/MDIX)	≥24 , 16 , 8
Porta uplink (baker/fiber) 100/1000Mbps SFP Slots	Min 2 Combo Opsionale
Porta Combo	Opsionale
Porte Console RJ45/RS232	1
Instalimi ne rack	19’’ rack mountable
Hyrje "Input"	
Tensioni Nominal	100~240VAC
Frekuenca	50/60Hz
Performanca dhe fleksibilitetit	
Bandëitdth/Backplan	≥ 48 (24porta), 20 (16porta), 16 (8 porta) Gbps
Throughput	≥ 35 Mpps

<i>Jumbo Frame</i>	<i>Opsionale</i>
<i>Tabele te Adresave MAC</i>	<i>16/8/ 4 k</i>
<i>Fan</i>	<i>Opsionale</i>
<i>Standartet</i>	
<i>IEEE 802.3 - 10BASE-T</i>	<i>Po</i>
<i>IEEE 802.3u - 100BASE-T</i>	<i>Po</i>
<i>IEEE 802.3ab -1000BASE-T</i>	<i>Po</i>
<i>IEEE802.3z -1000BASE-X</i>	<i>Po</i>
<i>IEEE 802.3ad - Agregim linku</i>	<i>Po</i>
<i>IEEE 802.3x -full duplex on 10BASE-T, 100BASE-TX, and 1000BASE-T ports</i>	<i>Po</i>
<i>IEEE 802.1d -Spanning Tree Protocol</i>	<i>Po</i>
<i>IEEE 802.1s- multi STP</i>	<i>Po</i>
<i>IEEE 802.1ë- RSTP</i>	<i>Po</i>
<i>IEEE 802.1q -VLAN</i>	<i>Po</i>
<i>IEEE 802.1x - Port-based Netëork Access Control</i>	<i>Po</i>
<i>IEEE 802.1p -QoS classification</i>	<i>Opsionale</i>
<i>IEEE 802.3at</i>	<i>Po</i>
<i>IEEE 802.3af- PoE</i>	<i>Po</i>
<i>Sistemi Operativ</i>	
<i>Te jete I orjentuar per operacionet LAN</i>	<i>Po</i>
<i>Te kete mundesi per upgrade</i>	<i>Po</i>
<i>Quality of Service</i>	
<i>Priority queues</i>	<i>Po</i>
<i>Queue scheduling</i>	<i>SP, ËRR</i>

<i>IGMP Snooping</i>	<i>V1/V2/V3</i>
<i>Spanning Tree</i>	<i>STP/RSTP/MSTP</i>
<i>LLDP</i>	<i>Po</i>
<i>BPDU Filtering/Guard</i>	<i>Po</i>
<i>Detektim te Loopback</i>	<i>Po</i>
<i>802.3x Floë Control</i>	<i>Po</i>
<i>VLAN</i>	<i>4k, (Voice VLAN Opsional)</i>
<i>Agregim te linkeve</i>	<i>802.3ad LACP</i>
<i>Adresimi IPv6</i>	<i>Po</i>
<i>DHCP/BOOTP, DHCP Snooping, DHCP Option82 per klientet</i>	<i>Po</i>
<i>Dynamic ARP inspection (DAI)</i>	<i>Po</i>
<i>Limitim te shpejtesise</i>	<i>Port/Floë</i>
<i>Policy-based routing (PBR)</i>	<i>Po</i>
<i>Routimi</i>	<i>Statik/ Dinamik, BGP, OSPF, IS-IS, ARP, IGMPv1/v2/v3</i>
<i>Siguria</i>	
<i>Access Control List</i>	<i>L2 - L4</i>
<i>TCP/UDP Ports</i>	<i>Po</i>
<i>Protokollin DSCP</i>	<i>Po</i>
<i>Authentication</i>	<i>TACACS+ , RADIUS, IEEE 802.1X, Port/MAC, SSH v1/v2, SSLv2/v3/TLSv1</i>
<i>Storm Control</i>	<i>broadcast, multicast, unicast</i>
<i>Menaxhimi</i>	
<i>Ëëb-based GUI dhe CLI.</i>	<i>Po</i>
<i>RS-232 console/ RJ45 Console</i>	<i>Po</i>
<i>Telnet, SSH</i>	<i>Po</i>

Monitorim te CPU	Po
SNTP	Po
Upgrade te Firmëare	TFTP ose nderfaqes Eëb
Ekran Led	Opsionale
SNMP v1/v2c/v3	Po
SYSLOG	Po

III.2.2. Në ligjin nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 23 pika 1, 2 dhe 3, parashikohet se :

“1. Specifikimet teknike, që përcaktojnë karakteristikat e mallrave, punëve dhe shërbimeve që do të prokurohen, duhet të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit kontraktor, duke iu referuar:

a) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve apo përdorimin e produkteve;

b) kërkesave në terma funksionalë, kur një gjë e tillë kërkon t’u referohesh standardeve kombëtare ose ndërkombëtare, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

c) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni për mallra, shërbime apo punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

III.2.3. Në nenin 28, pika 1; 2 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se: *Natyra e shërbimeve duhet të shprehet qartë në termat e referencës, ku përfshihen objekti, qëllimi, specifikimet teknike dhe afatet kohore të shërbimit që do të kryhet. 2. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura*

ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet

III.2.4. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se autoriteti kontraktor në hartimin e specifikimeve teknike krahas përshkrimit të saktë të nevojave të këtij të fundit duhet të kenë në vëmendje faktin se hartimi i specifikimeve teknike duhet bërë në një mënyrë gjithpërfshirëse duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve duke përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë karakteristikat e mallrave/shërbimeve/punëve dhe në përpuethshmëri me objektin e kontratës. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se specifikimet teknike duhet të jenë sa më gjithpërfshirëse, por pa cënuar thelbin e garancisë mbi cilësinë e shërbimit/punës/mallit që autoriteti kontraktor kërkon të prokurojë. Akoma më tej Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kërkesat e autoritetit kontraktor për :

Policy-based routing (PBR)	<i>Po</i>
Routimi	<i>Statik/ Dinamik, BGP, OSPF, IS-IS, ARP, IGMPv1/v2/v3</i>
Access Control List	<i>L2 - L4</i>

Si dhe



Policy-based routing (PBR)	<i>Po</i>
Routimi	<i>Statik/ Dinamik, BGP, OSPF, IS-IS, ARP, IGMPv1/v2/v3</i>
Access Control List	<i>L2 - L4</i>

janë kërkesa të ekzagjëruara duke marrë në konsideratë qëllimin e projektit. KPP gjykon se duhet të merren në parasysh sugjerimet për ndryshimin e switcheve pasi rrisin në mënyrë artificiale koston e projektit pa asnjë arsye specifike. Përderisa në seksionin 10 “Planifikimi i Buxhetit për ndërtim” autoriteti kontraktor ka parashikuar sasinë e kablllove dhe të pajisjeve që do të shpërndahen në terren, atëherë në këtë projekt duhet të gjenden edhe një planifikim të distancave dhe vendeve ku do të vendosen këto pajisje. Në këtë kuptim autoriteti kontraktor duhet të jetë më i qartë dhe konkret në kërkimet e tij në lidhje me projektin me anë të së cilit mund të arrijë qëllimin e projektit me pajisje të cilat kanë specifikime teknike të pajisjeve të cilat nuk rrisin koston e projektit. Përsa më sipër autoriteti kontraktor duke qënë se kërkesat për switch janë të ekzagjëruara për funksionin që kërkohet të kenë, karakteristikat Policy-based routing (PBR), Routimi Statik/Dinamik, BGP, OSPF, IS-IS, ARP, IGMPv1/v2/v3, Access Control List L2- L4 të hiqen.

Pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimet e palës ankimuese mbi modifikimin e dokumentave të tenderit me argumentin se:

“ Ankesë 3

Në ankesën nr. 3 pika 3 të datës 11.10.2017 të paraqitur nga ana jonë kemi kërkuar:

Referuar specifikimeve teknike të Media converter sic praqitet në faqen 17, kërkohet që Netëork Media të jetë UTP category 5, ndërkohë që kablli i bakrit kërkohet që të jetë cat 6. Ju lutem specifikoni më qartësisht tipin e kabllit të bakrit që duhet të përdoret?

Në përgjigjen e datës 18.10.2017 Bashkia Malësi e Madhe është përgjigjur:

Pika 3 Është e qartë nga specifikimet dhe projekti që media konverteri deri tek sëitchi mund të jetë cat5 ndërsa kabulli që lidh akses pointet me sëitchet duhet të jetë cat 6.

Arsyetimi për KPP

Sipas përgjigjes së dhënë nga AK-ja është përcaktuar që lidhja nga media converter deri tek sëitchet do të bëhet me cat 5 FTP ose UTP, por nuk është përcaktuar në asnjë zë të preventivit të dhënë sasia e tij. Në këto kushte duke qënë se sasia e kabllit është e rëndësishme për vlerësimin e cmimit të ofertës së operatorit ekonomik kërkojmë.

Kërkesë 3KPP

Vendosjen në preventivin e mallrave të zërit “Kabëll Kategoria 5” me sasinë përkatëse.

III.3.1. Në dokumentat e tenderit “Termat e Referencës” pika 10. “Planifikimi i Buxhetit për Ndërtimin e Sistemit” është kërkuar:

PLANIFIKIMI I BUXHETIT PËR NDËRTIMIN E SISTEMIT

Me poshte paraqitet tabela e planifikimit te buxhetit:

Nr.	Emertimi	Sasia	Cmimi	Vlera
1	Implementimi, konfigurimi i sistemit ëifi	1		
2	UPS ne qendrën e bashkisë dhe njesi	1		
3	Ëireless kontrollor	1		
4	Licenca per menaxhim akses point	76		
5	Sëitch 24 porta	1		
6	Sëitch 16 porta	7		
7	Sëitch 8 porta	4		
8	Media konverter	14		

9	Firewall	1		
10	OutDoor Access Point	76		
11	Fiber optike	1800		
12	Kostot kablli ftp cat 6	6180		
13	Outdoor Cabinets	7		
14	Dizenjimi, implementim dhe dokumentimi i sistemit nderveprues dhe raportimit	1		
15	Trajnimi i stafit IT te Bashkise	1		
	<i>Totali (Leke me tvsh)</i>			

III.3.2. Në dokumentat e tenderit “Kwrkesat Teknike” pika 14. “Media converter” është kërkuar: [...]

Standards	IEEE 802.3ab, IEEE 802.3z, IEEE 802.3x
Network Media	<u>UTP category 5, 1000BASE-T, Single-mode Fibër -1000BASE-LX</u>
Connectors:	RJ45 port, 1000Base-T
	Fibër SC duplex port, 1000Base-LX
Distance	Up to 10km
Transfer Rate	1 Gbps
LEDs	Power, Link/Activity, Full-Duplex, and Speed
Power Adapter	External Power Adapter
Features	Full Duplex Flow Control (IEEE 802.3x)
	Works at 1000Mbps in Full-Duplex mode for both TX port and FX port Supports auto MID/MID-X for TX port Easy-to-view LED indicators provide status to monitor network activity easily

[...]

III.3.3. Referuar sa më sipër KPP gjykon se pretendimi i ankimuesit se “është përcaktuar që lidhja nga media converter deri tek switchet do të bëhet me cat 5 FTP ose UTP, por nuk është përcaktuar në asnjë zë të preventivit të dhënë sasia e tij. Vendosjen në preventivin e mallrave të zërit “Kabëll Kategoria 5” me sasinë përkatëse.” i cili kërkohet për hartimin e ofertës është i bazuar. KPP gjykon se autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për modifikimin e specifikimit teknik duke parashikuar në mënyrë specifike llojin e kabllit nga Media converter tek switch-i.(specifikimet teknike të përshkruhen ose cat 5 ose të dyja cat 6), pra autoriteti kontraktor duhet të unifikojë përcaktimin e bërë për një kategori të caktuar në të gjithë dokumentat e tenderit ku përshkruhet një zë i caktuar, domethënë në çdo vend të dokumentave të tenderit ku flitet për elementin “Cat”, duhet të bëhet përcaktimi i saktë dhe i qartë që në të gjitha vendet të jetë “Cat 5” ose “Cat 6” siç i nevojitet autoritetit kontraktor dhe jo në një vend “Cat 5” dhe në një vend tjetër “Cat 6”, pasi një përcaktim i tillë do të sillte konfuzion si tek operatorët ekonomikë gjatë hartimit dhe përgatitjes së ofertës së tyre ashtu edhe tek komisioni i vlerësimit të ofertave gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave. Sa më sipër, autoriteti kontraktor duhet të bëjë modifikimin përkatës sipas arsyetimit të mësipërm. Pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimin e palës ankimuese mbi modifikimin e dokumentave të tenderit me argumentin se Ankesë 4 Në ankesën nr. 3 pika 10 të datës 11.10.2017 të paraqitur nga ana jonë kemi kërkuar:

Shtrimi i fibrës optike nuk paraqitet në preventiv nëse është pjesë e këtij projekti? Apo do të bëhet nga palë tjetër? Nëse do të bëhet nga i njëjti kontraktues do të merret parasysh në ofertën e cmimit në të njëjtin zë që është edhe fibra? Nëse do të kryhet nga ana jonë shtrirja e fibrës do të bëhet në tubacionet ekzistues apo do të shtrihen tubacione të reja?

Në përgjigjen e datës 18.10.2017 Bashkia Malësi e Madhe është përgjigjur:

Pika 10 Projekti do të konsiderohet si me “celësa në dorë”. Të gjitha punimet e nevojshme për fibrën optike, shtrim kabulli bakri, montim aksel pointesh, montim rackesh duhet të ofrohen dhe do të kryhen nga oe fitues. Po duhet marrë parasysh në të njëjtin cmim është edhe fibra. Në varësi të hartës së mbulimit duhet të merret parasysh dhe shtrimi i fibrës. Në rastet kur ekziston tubacioni ekzistues do përdoret ai në rastet kur nuk ekziston do të shtrihet i ri.

Arsyetimi KPP

Koncepti me “celësa në dorë” nuk mund të nënkuptojë që zërat si hapje kanalizimesh dhe shtrim tubacionesh përfshihen në zërin fibra. Hapja e kanalizimeve dhe shtrirja e tubacioneve të reja është një pikë kryesore për krijimin e rrjetit të kërkuar, por që ngelet tërësisht e patrajtuar në dst Në varësi të hartës së mbulimit autoriteti është i detyruar të japë minimalisht kanalizimet ekzistuese që mund të përdoren në mënyrë që operatori të mund të gjykojë mbi sasinë e zërit shtrirje dhe instalim fibre, ku do të përfshijë (hapje kanalizimes të reja shtrirje tubacionesh)etj. Fakti që shtrirja e fibrës optike do të bëhet nga oe-ja duhet të ishte theksuar që në projektin e dhënë nga ana juaj pasi sasia e punimeve civile tubacioneve të reja që do të shtrihen etj janë zëra të cilat kanë një ndikim të tepërt të konsiderueshëm në koston e të gjithë projektit. Minimalisht AK-ja duhet të kishte përcaktuar qartë rrugën në të cilën do të shtrihet fibra optike pjesët që do të shtrihen në kanalizimet ekzistuese

dhe ato pjesë për të cilat do të ishte e nevojshme shtrirja e tubacioneve të reja dhe kanalizimeve të reja. Gjithashtu nuk është përcaktuar se në pronësi të kujt do të jenë makineritë me anë të të cilave do të kryhen punimet civile si psh carja e asfaltit gjermimi etj. Sipas një llogjike të thjeshtë presupozohet që do të jenë në pronësi të Bashkisë përderisa nuk është kërkuar asnjë makineri nga ana e oe-së apo gjatë realizimit të projektit mund të pretendohet që oe –ja duhet ta dinte që duhet të kishte në pronësi këto lloj makinerish,.

Kërkesë 4 KPP

Të përcaktohen kanalizime ekzistuese ku do të kalojë fibra optike dhe kanalizimet e reja.

III.4.1. Referuar kthim përgjigjes së autoritetit kontraktor lidhur me këtë pikë të ankesës konstatohet se konkretisht citoj :[...] *Projekti do të konsiderohet si me “celësa në dorë”. Të gjitha punimet e nevojshme për fibrën optike, shtrim kabulli bakri, montim akses pointesh, montim rackesh duhet të ofrohen dhe do të kryhen nga oe fitues. Po duhet marrë parasysh në të njëjtin cmim është edhe fibra. Në varësi të hartës së mbulimit duhet të merret parasysh dhe shtrimi i fibrës. Në rastet kur ekziston tubacioni ekzistues do përdoret ai në rastet kur nuk ekziston do të shtrihet i ri.*

Ndërkohë nuk janë dhënë shpjegimet e duhura lidhur me hartën e mbulimit të zonave. KPP gjykon se në momentin që operatorët ekonomikë potencialë të mundëshëm nuk kanë një hartë planifikimi të pikave që do të lidhen atëherë këta të fundit nuk mund të bëjnë një ofertim të qartë për fibrën optike, edhe për faktin që ky shtrim do të përfshihet në hartimin e çmimit të ofertës. Në këtë kuptim akoma më tej KPP gjykon se, autoriteti kontraktor duhet të marrë masat e nevojshme për përcaktimin e detajuar të këtyre elementëve pasi nëse këto zëra do të ofrohen nga operatori ekonomik ato duhet të jenë pjesë e grafikut të lëvrimit, ndërsa në të kundërt autoriteti kontraktor duhet të shprehet qartë në specifikimet teknike që ky zë do të ofrohet nga burimet e institucionit.

Përsa më sipër pretendimi i ankimuesit qëndron.

III.5. Gjithashtu, nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, rezulton se autoriteti kontraktor në datën 30.10.2017 ka vijuar me hapat e mëtijshëm të procedurës së prokurimit me “Dorëzimin e Ofertave”. Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin se përcaktimi i procedurave dhe afateve të caktuara procedurale në LLP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga afati për përgatitjen e ofertës, afati i shqyrtimit të ofertave, afati i ankimimit etj, përfaqësojnë garanci dhe siguri juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike, (Neni 9 i K.pr. Administrative). Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga *lex specialis* LPP, në neni 2 të tij janë ato të mos diskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementëve të mësipërm lidhet ngushtësisht me elementë të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike. Në nenin 63 pika 2 e ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se “Ankesa kundër vendimeve të autoritetit kontraktor i paraqitet, së pari, me shkrim, autoritetit kontraktor në fjalë brenda 7 ditëve nga dita e nesërme e punës kur ankimesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkeljen e pretenduar, sipas këtij ligji.” Në nenin 63 pika 3 e *lex specialis*, LPP parashikohet se “ Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi përpara skadimit të afatit kohor, të përcaktuara në pikat 5 dhe 6 të këtij neni.” Gjithashtu në nenin 63 pika 6 e *lex specialis* i cili parashikon të drejtën ankimit pranë Komisionit të Prokurimit Publik parashikon se “ [...] Nëse autoriteti kontraktor nuk shqyrton ankesën brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të këtij

neni, ose e refuzon atë, ankimuesi mund të paraqesë një ankesë me shkrim në Komisionin e Prokurimit Publik brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e punës, pas përfundimit të afatit kohor, të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose, në rast se ankesa nuk pranohet nga autoriteti kontraktor, që nga dita kur ankuesi është njoftuar nga autoriteti kontraktor. Një kopje me shkrim e ankesës i dërgohet detyrimisht edhe autoritetit kontraktor [...]”.

III.5.1. Autoriteti kontraktor ka vepruar në kundërshtim të hapur me ligjin duke shkelur afatet proceduriale të ankimit duke vijuar me “Dorëzimin e Ofertave” brenda hapësirës ligjore ku operatorëve ekonomikë ankimes i lind e drejta e shterimit të ankimit administrativ në një shkallë më të lartë ankimi. Autoriteti kontraktor ka detyrimin të presë përfundimin e plotë të afateve të ankimit të operatorëve ekonomikë ankimes pranë Komisionit të Prokurimit Publik në zbatim të nenit 63 pika 3 dhe pika 6 e LPP-së. Referuar parashikimit të mësipërm, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se operatori ekonomik ankimes ka qenë brenda afateve kohore të ankimit pranë K.P.P në momentin e “Hapjes së Ofertave” të procedurës së prokurimit.

III.5.2. Bazuar në nenin 64 pika 3 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se “3. Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik, kur gjykon se një vendim apo veprim i autoritetit kontraktor ka shkelur ndonjë nga dispozitat e këtij ligji, ka të drejtë: a) të nxjerrë një interpretim për rregullat ose parimet ligjore, që duhet të zbatohen për objektin e ankesës; b) të anulojë, plotësisht ose pjesërisht, një veprim ose vendim të autoritetit kontraktor, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin. Kjo përfshin edhe të drejtën për të hequr të gjitha ato specifikime teknike ose llojet e tjera të specifikimeve që bien ndesh me këtë ligj; c) të udhëzojë autoritetin kontraktor të korrigjojë shkeljet dhe më pas të vazhdojë me procedurën e prokurimit të kontratës; ç) të urdhërojë anulimin e procedurave për shpalljen e kontratës fituese.”

III.5.3. Në nenin 27 “Kufijtë e shqyrtimit të ankesës” të VKM nr. 184, datë 17.03.2010, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar; parashikohet se: “ [...]. Komisioni shqyrton ankesën brenda objektit dhe shkaqeve të parashtruara në ankesë. 2. Përgjatë, kur ka lidhje midis objektit të ankesës dhe vendimeve apo veprimeve të tjera të autoritetit kontraktor gjatë procedurës së prokurimit, Komisioni vendos edhe për ligjshmërinë e tyre [...]”.

III.5.4. Në nenin 28 pika 2 gërma “d” të VKM, nr. 184, datë 17.03.2010, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik” parashikohet se “[...] Komisioni, pas shqyrtimit administrativ të ankesës vendos me akt të motivuar: d) Të anulojë procedurat për shpalljen e kontratës fituese dhe të udhëzojë autoritetin kontraktor për rifillimin e procedurës së prokurimit [...]”

III.5.5. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për shkak të shkeljeve të mësipërme të konstatuara procedura e mësipërme e prokurimit duhet anuluar, në zbatim të nenit 64, pika 2 gërma “ç” dhe nenit 24 gërma “dh” të ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, i cili parshikon se “Autoriteti kontraktor anulon procedurën e prokurimit vetëm: dh) kur Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin, sipas parashikimit të shkronjave “b” dhe “ç” të pikës 3 të nenit 64 të këtij ligji.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 23 të VKM nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “B 360” shpk për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*” me Nr.REF-28817-10-06-2017, me objekt : “*Sistemi Wi-Fi per qytetin, shkollat dhe qendra te populluara te njesive administrative*”, me fond limit 12 279 042 lekë pa tvsh, parashikuar për tu zhvilluar më datë 30.10.2017 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Malësi e Madhe.
2. Anulimin e procedurës së mësipërme të prokurimit dhe me rishpalljen e saj, autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse në përputhje me arsyetimet dhe konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues ekonomik “B 360” shpk
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1615 Protokolli; Datë 25.10.2017

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Zv/Kryetar
Leonard Gremshi

Anëtar
Hektor Balluku

Anëtar
Kleves Janku

Anëtar
Odise Moçka

Kryetar
Evis Shurdha